



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e II-të (dytë - mandati VIII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 18 gusht 2026

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10:20

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët e këtij Komiteti dhe atë:

z.Ardi Hasani; znj.Vlora Jashanica; znj.Blerta Azemi-Berisha; z.Besim Latifi; z.Demokrat Hodolli; z.Rrhaim Sejdiu; znj.Vlorjana Avdiu; z.Xhafer Ademi; znj.Dorontina Tahiri; z.Muhamet Sadiku; znj.Sevdije Mustafa.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm tjerë ishin: z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK; z.Bekim Karaxhija dhe Mefail Mustafa përfaqësues të OSBE-së; z.Papp Kornelia dhe Vitkoci Gabor përfaqësues i KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, sot kemi mbledhjen e dytë të Komitetit për Komunitete e cila është thirr me këtë rend të ditës (lexon pikat e rendit të ditës), andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim kështu siç ju është dërguar

Njëzëri me 10 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit për Komunitete që ishin prezent, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja inauguruese e mbajtur më 17 korrik 2026

Pas votimit, Njëzëri me 10 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit për Komunitete që ishin prezent, u konstatua se miratohet, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, Procesverbali nga mbledhja inauguruese e mbajtur më 17 korrik 2026

2. Propozim Plani i punës së Komitetit për pjesën e mbetur të vitit 2026 (i cili do të prezantohet nga Grupi Punues përkatës)

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne Grupi punues jemi takuar dhe kemi përgatitur Planin e punës për këtë pjesë të mbetur të vitit 2026, Plan të cilin e kemi përshtatur nga Plani i vitit të kaluar disa pjesë mirëpo kemi planifikuar disa ndryshime të cilat do t'i paraqes tani, pra nuk po e lexoj gjithë propozimin e Planit të punës sepse ju e keni pranuar në e-mail, mirëpo i lexoj vetëm ndryshimet që kemi vendos si Grup punues.

Në faqen 3 ku janë aktivitetet e Komitetit për Komunitete të planifikuara;

-Vizitë komuniteteve jo shumicë në Lagjen ku jetojnë në rr."Xhafer Meta" e kemi planifikuar të mbahet më 13.09.2026, pra në këtë Lagje do të shkojmë si Komitet për të vizituar komunitetin jo shumicë që jeton aty, do t'i dëgjojmë problemet dhe nevojat e tyre, kurse për kohën dhe vendin e takimit tonë do të koordinohemi më pastaj përmes komunikimit me telefon.

-Po në faqen 3 kemi planifikuar edhe vizitë në Lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Ali Ajeti" e cila është paraparë të bëhet më 02.11.2026 e që po ashtu edhe në këtë Lagje do të njoftohemi me problemet dhe nevojat e tyre që do t'i paraqesin, pra do të njoftohemi për së afërmi të gjithë ne anëtarët e këtij Komiteti edhe pse disa prej neve i dim disa prej atyre problemeve dhe nevojave që kanë.

-Gjithashtu në këtë faqe kemi planifikuar të bëjmë vizita edhe Lagjet në fshatrat Batllav dhe Orllan ku jetojnë komuniteti jo shumicë, dhe atë më 12.10.2026 e që do të shikojmë problemet, brengat dhe nevojat e komunitetit jo shumicë që jetojnë në ato Lagje të fshatrave të cekura.

-Në faqen 4 kemi planifikuar vizita edhe nëpër shkollat e Qytetit "Naim Frashëri" "Dr.Ibrahim Rugova" dhe "Shaban Shala", mirëpo për këto vizita kemi planifikuar t'i caktojmë sipas mundësive dhe rrethanave të krijuara sepse nuk mund t'i planifikojmë sot për arsye se fillimisht duhet të kontaktojmë me drejtorët e këtyre shkollave e pastaj sigurisht që do koordinohemi dhe njoftohemi të gjithë anëtarët e këtij Komiteti. Pra në këto vizita do të shikojmë dhe do të interesohemi për nxënësit e komuniteteve jo shumicë se a po e vijnë mësimin, a ka braktisje të shkollimit dhe do të interesohemi edhe për çështje tjera lidhur me nxënësit e komuniteteve jo shumicë që vijnë mësimin në këto shkolla të qytetit, sidomos për regjistrimin e nxënësve në parashkollor dhe në klasë të I-rë.

Këtë propozim Plan ju e keni marrë dhe lexuar dhe ai propozim mbetet ashtu siç është, kurse këto që i paraqita janë ndryshimet dhe plotësimet e bëra nga ana e Grupit punues, prandaj urdhëroni e hap diskutimin rreth këtij plani kush dëshiron fjalën për plotësime, ndryshime, vërejtje, ide dhe çështje tjera varësisht çka paraqitet.

Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, atëherë e hedh në votim propozim planin e punës së Komitetit për Komunitete sipas materialit që ju është dërguar, përfshirë edhe propozimet e Grupit punues që i paraqita në këtë diskutim.

Pas votimit, Njëzëri me 10 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit për Komunitete që ishin prezent, u konstatua se miratohet Plani i punës së Komitetit për pjesën e mbetur të vitit 2026, sipas dokumentit bazik të dërguar si dhe propozimeve të grupit punues për plotësime dhe ndryshime të prezantuara nga Kryesuesi i Komitetit.

Plan i cili do t'ju dërgohet të gjithë anëtarëve të Komitetit për Komunitete, Shefit të ZKKK, OSBE-së si dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqe të Komunës.

3. Diskutim lidhur me gjendjen e Komuniteteve jo shumicë që jetojnë në zona dhe lagje të ndryshme në Komunën e Podujevës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, këtë pikë të rendit të ditës e kam paraparë duke marrë për bazë që tani jemi në fazën e përgatitjes së buxhetit të Komunës për vitin 2027.

Problem kryesor te komuniteti jo shumicë momentalisht është uji i pijes dhe mbeturinat, pra edhe në këto temperatura të larta që po jenë, ditën nuk kemi ujë të pijes fare në Lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë e që nuk është numër i vogël i tyre në rr.”Ali Ajeti”, natën vie nganjëherë për rreth 1 orë ka ujë, mirëpo për 1 orë është e pamundur t’i kryejmë të gjitha detyrat e shtëpisë që kemi të gjithë pothuajse ngjashëm siç janë larja e rrobave në lavatriqe, pajisjet tjera të sanitarisë e të tjera, kështu edhe më parë kemi pas probleme të tilla të ngjashme mirëpo tash së fundmi është ndërruar Gypi i Ujësjiellësit dhe është bërë një investim bukur i madh nga an e Komunës dhe Ministrisë, mirëpo ai gyp ka mbete pa ujë, kështu që po e them se është rrezik të na hapet ndonjë epidemi si shkak i mungesës së ujit.

Pastaj edhe mbeturinat nuk po merren në atë lagje edhe përkundër faktit që komunitet në atë lagje kemi hapësira të ngushta dhe të vogla, era kundërmon në tërë lagjen dhe edhe si shkak i kësaj mund të vie deri te ndonjë epidemi, se për gripa nuk po flasim fare se ato janë të pranishëm. Pra janë probleme shumë të mëdha, kështu që unë do t’ju lusja anëtarët e Kuvendit që janë edhe anëtar të këtij Komiteti të paraqesin këtë gjendje në Kuvendin e Komunës. Jemi në dijeni që Kryetari i Komunës e ka shpall Gjendje Emergjente, mirëpo angazhimi në atë, lagje është shumë i vogël në këtë drejtim. Ne si komitet në atë lagje ngapak po merremi vet me këtë problematikë dhe po i bartim vet disa, mirëpo prap se prap problemi i mbeturinave mbetet kyç në atë lagje ngase siç e ceka ne i kemi shtëpitë ku banojmë me oborre të ngushta, pastaj ka raste ku një oborr jetojnë 5-6 familje dhe tani merreni me mend secili ta ketë nga një shportë të mbeturinave aty në oborr, kështu që ky si problem është bukur i madh, prandaj ju lus edhe njëherë që këtë problem ta paraqesin në Kuvendin e Komunës dhe të mundohen të gjejnë ndonjë zgjidhje se qysh ka mundësi të kapërcehet kjo gjendje.

Për fillim unë kisha këtë rezyme të shkurtër rreth kësaj teme, kurse tani e hap diskutimin, urdhëroni fjala është për ju.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, kam pyetje për Kryesuesin e këtij Komitete, kur ti je interesuar për problemin e ujit, cila ka qenë përgjigja dhe cila ka qenë arsyeja pse nuk ka ujë në atë pjesë të qytetit edhe pas ndërrimit të gypit.

Kryesuesi i Komitetit, përgjigje parafolësit, theksoi, po ne në fakt jemi interesuar për këtë çështje, madje e kemi telefonuar edhe Kryetarin e Komunës, nga znj.Dorontina Tahiri është kontaktuar sa jam në dijeni. Në fakt ne ujë nuk kemi pasë as natën, pro pas e kemi kontaktuar Kryetarin e Komunës siç e cërka, është ndërhyrë tek ujësjiellësi dhe tani natën ujë po kemi nga 1 orë maksimum 1 orë e gjysmë, po gjendemi qysh po mundemi por ta keni parasysh që kur lëshohet uji për veç 1 orë ose hajde epo themi edhe 2 orë, e tërë lagja lëshohet përnjëherë të kryej të gjitha punët me ujë, dhe pastaj natyrisht se paraqiten probleme edhe me shtypje pastaj sepse reduktohet nga vlugu i madh i shfrytëzimit, makinat dhe pajisjet e ndryshme shtëpiake nuk punojnë, po ashtu bojlerët nuk punojnë, kështu që kjo është situata.

Investimi është bërë në atë pjesë të qytetit, por ujë nuk ka, arsyen nuk e dim përse edhe pse jemi ankuar në shumë vende, sërish ujë nuk ka, premtime ka vazhdimisht se do e lëshojnë po sërish ujë nuk ka.

Sa e di unë, aty qëndron një problem prej ndërrimit të gypave para rreth dy viteve, sakt nuk po më kujtohet, që kur janë vendos gypat ka pasë telashe teknike të cilat mbrapa në disa pjesë të kësaj rruge janë riparuar. Pra pyetja është kështu më konkret, kur e keni adresuar këtë problem dhe këtë shqetësim ju si komunitet, çfarë përgjigje keni marrë, cili është problemi dhe qysh duhet të zgjidhet ky problem, dhe a ju ka dhënë ndokush ndonjë përgjigje rreth kësaj që e paraqitët.

Pastaj me investimet që janë bërë nga Kryetari i Komunës dhe Ministria përkatëse, është bërë ndërrimi i atij gypi që ka qenë kërkesë e jona vazhdimisht, mirëpo tani ujë nuk kemi. Problemi që mendoj unë është kështu, ujë ka poshtë lagjes megjithëse edhe atje shtypja e vogël, por shtypje fare nuk ka këndeje në pjesën nalt tek ne, kështu që është bërë ndërrimi i Gypit por prap qëndron i njëjti problem.

Unë propozoj që në mbledhjen e radhës më mirë mund të na njoftoj drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit rreth këtyre temave, pra ta planifikojmë si pikë në kuadër të rendit të ditës.

Page 4 of 8

Çështjet tjetra që kanë të bëjnë me gjendjen e komuniteteve jo shumicë, edhe Plani i punës sipas të cilit do të kemi vizita të ndryshme por që edhe disa i dim sepse i kemi parë edhe më parë si gjendje faktike qoftë me asambleistë tjerë që kanë qenë por edhe me organe tjera që janë pjesë e kësaj e që mund të na bashkëngjitet e KFOR, Policia, OSBE që ta verifikojmë gjendjen reale se qysh jetojnë komuniteti jo shumicë në pjesë dhe fshatra të ndryshëm të Komunës së Podujevës, për format, mënyrat dhe nevojat se çka ata i paraqesin drejtpërdrejtë në vizitat që do të bëjmë.

Po ashtu dua të them se këtu kemi edhe asambleistë që janë pjesë e këtij Komiteti dhe ata mund ta dinë edhe më mirë se në muajin shtator është projektbuxheti i Komunës për vitin 2027 dhe planifikimet buxhetore për dy vitet pasuese, dhe është e drejtë legjitime e juaja që t’ju bëni thirrje përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë nga zonat, lagjet dhe fshatrat e ndryshëm që t’i parashtrajnë kërkesat e tyre me shkrim në Drejtoritë përkatëse, qoftë në Arsim, Shëndetësi, Infrastrukturë, Shërbime Publike, Bujqësi dhe të gjitha dikasteret tjera, dhe ato kërkesa normale se do të merren para sysh dhe kur të ketë mbledhje të Kuvendit të Komunës janë në gjendje t’ju ndihmojnë në kërkesat e paraqitura duke i aprovuar ato dhe duke i përfshirë në projektbuxhet, përndryshe ne mund të diskutojmë edhe në mënyrë teorike mirëpo buxheti parasheh edhe kosto financiare, andaj duke parë këto gjëra dhe problemet e atyre që janë normale si çështje, ne pastaj i diskutojmë. Në fakt unë e di gjendjen reale të komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës përveç atyre që Kryesuesi i potencoj, sepse jemi bashkërisht duke jetuar në një zonë që është Komuna e Podujevës dhe e dim se problemi më i madh është çështja e strehimit, çështja e pronave si tema që janë e që mund t’i diskutojmë, por ato janë çështje legjitime që prona është pronë dhe është e patjetërsueshme dhe nuk mundet askush të intervenoj përveç atyre që kanë nevojë për strehim dhe që kanë pronën e vet. Në këtë aspekt ne kemi intervenuar në shumë raste për t’ju gjet një strehim apo thënë ndryshe një kulm mbi kokë.

Pastaj çështje tjera që janë problematike, ne jemi në dijeni tani në këtë situatë që po jetojmë është edhe punësimi e që është një element interesant sepse tani së fundmi më shumë po angazhohen në marrëdhënie punë në sektorin privat, por normale që në sektorin publik janë disa kriteret tjera që hyjnë një konkurrencë më strikt dhe në kuptimin e konkurrencës çdo herë që mund të jepen disa poena shtesë, mirëpo në sektorin privat janë të pranuar në shumë sektorë të ndryshëm ku punojnë persona të komunitetit jo shumicë e që ne i dim, qoftë në gastronomi, qoftë në ndërtimtari, qoftë në Kompaninë “Pastrimi” dhe në sektorë tjerë, dhe këto çështje mund t’i diskutojmë, pra ajo që dua të them është se ata që duan dhe që janë të interesuar të punojnë edhe gjejnë punë dhe punojnë, mirëpo ajo që kam përcjellë një statistikë thuajse nga vitit 2000 e kënde, e mira dhe pozitivja është që tani ka rënie të rasteve në Qendrën për Punë Sociale sepse njerëzit tani e kanë parë që nuk jetohet me ndihma sociale dhe kanë gjetë alternativa tjera për të ardh deri te punësimi, sidomos te komunitetet jo shumicë, prandaj sipas statistikave për çdo ditë thuajse ka rënie të numrit sepse njerëzit siç e potencova janë vetëdijesua dhe duan të punojnë, të vetëfinancohen si dhe të kryejnë edhe obligimet ndaj qytetarëve.

Pra kjo temë më ka nxitur edhe kureshtje që të diskutoj, mirëpo unë sërish ju them se është muaji shtator dhe të gjitha propozimet, kërkesat, problemet t’i paraqitini me shkrim tek drejtoritë përkatëse varësisht kërkesave dhe fushave përkatëse, ndërsa për çështjet që u diskutua në fillim (uji i pijes dhe mbeturinat) është mirë që në mbledhjen e radhës së këtij Komiteti të parashihet si temë në kuadër të rendit të ditës dhe t’i behet ftesë për të qenë prezent edhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit i cili mund të na informojë më mirë dhe sakt rreth këtyre çështjeve sepse është kompetent për këto çështje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, gjithashtu dua ta them edhe një gjë që komuniteti jo shumicë për momentin ka nevojë ndërtimin e disa shtëpive. Kemi një familje e cila jeton me 10 anëtarë në një

dhomë dhe atë shumë të vogël, 3x4, familje e cila i ka disa fëmijë shumë të vogël, madje më besoni që kur zgjohemi në mëngjes themi “mos ka ndodh ta mbytetë ndonjë prej tyre gjatë fjetjes” sepse fëmijët im ka të vegjël, kështu që ka nevojë të merremi edhe me çështjen e ndërtimit të ndonjë shtëpie për familje të tilla të komunitetit jo shumicë, e sidomos t’ju them të drejtën të mundohemi të gjejmë ndonjë donatorë që vie këtu dhe lajmërohet, të merren para sysh këto familje dhe t’iu prezantohet atyre për ndihmë në ndërtimin e shtëpive, ndërsa për meremetim, riparim apo renovim të shtëpive të komuniteteve jo shumicë ka shumë raste por meqë janë brenda kulmit të shtëpisë dhe ka hapësirë të mjaftueshme mund të themi se kanë më të lehtë.

Po ashtu komuniteti jo shumicë në Komunën e Podujevës ka nevojë për punësim, e them këtë sepse më parë kemi thënë dhe ka qenë e ditur se nuk ka të shkolluar, mirëpo tani kemi si komunitet njerëz të shkolluar dhe të, përgatitur, por tani siç e ceku edhe parafolësi zotëri Zeqiri tash edhe sektori privat po kërkon punëtorë dhe ata që janë të interesuar po paraqiten dhe po punësohen më lehtë. Në institucionin e Komunës nuk kemi të punësuar nga komuniteti jo shumicë përveç një pastruesi, kështu që mund të them haptas se Komuna është etnikisht e pastër sa i përket punësimit, është vetëm një pastrues i cili punon këtu, prandaj do të, propozoja që kur ka konkurse të hapura t’i kenë parasysh personat e komunitetit jo shumicë që të punësohen, kjo është ajo që mund ta them, sepse tani falë Zotit komuniteti jo shumicë është vetëdijësuar dhe kemi nxënës/e mjaftueshëm nëpër shkolla, madje ata që e përfundojnë shkollimin fillor pastaj për shkollim të mesëm nuk po e diskutojmë fare sepse po e vazhdojnë atë në mënyrë të rregullt dhe po e kryejnë atë, mirëpo çka është më pozitivja se më parë vajzat e komuniteteve jo shumicë nuk kanë shkuar shumë në shkollë, por tani interesante është që më shumë kemi vajza në procesin e shkollimit, madje kemi edhe në fakultete por edhe që kanë kryer fakultetet, prandaj më parë nuk kemi pasë të arsimuar dhe të përgatitur për punësim por tani i kemi dhe mund të punësohen.

Kjo çështje mund të jetë temë e gjerë që të diskutohet.

Në lagjet e fshatrave ku jetojnë komuniteti jo shumicë mund të them se sa i përket ujit gjendja është më e mirë sepse kanë ujë, kurse për mbledhjen e mbeturinave nuk e di qysh qëndron gjendja, nuk kam informata.

z.Besim Latifi, theksoi, lidhur me çështjen e punësimit vetëm deshta ta di nëse keni një regjistër të atyre që kanë kualifikime për secilën prej lagjeve ku jetojnë komunitetet jo shumicë në mënyrë që ta dim sa ekonomistë janë, sa juristë ose sa të tjerë të profileve tjera. Pra ta kemi një listë të, atyre personave të cilët kanë kualifikime dhe që janë të pa punë, a keni një listë ju si komunitet jo shumicë lidhur me këtë që e ceka.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, një listë të tillë e kemi, por këtu me vete tani nuk e kam sepse nuk e kam ditë që do të kërkohet një gjë e tillë, mirëpo atë listë mund t’ju dërgoj në mbledhjen e radhës të Komitetit. Është shumë mirë kjo që u kërkua sepse është pyetje me vend që të dihet sa persona të komunitetit jo shumicë janë me kualifikim dhe çfarë kualifikimesh kanë.

z.Liman Zeqiri, Shef i ZKKK, theksoi, i nderuar Kryesues më duhet të të reagoj sepse ne ka kohë të gjatë që punojmë bashkë. Nuk është e vërtetë ajo që e potencove “etnikisht e pastër”, e them këtë sepse fjala Etnikisht është fjalë e cila “vranë” paksa, andaj meqë punojmë bashkërisht për një kohë të gjatë dhe jeni në dijeni ju se sa kam kontribuar unë dhe kamë ndihmuar bash për juve si komunitet jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Konkurset janë të hapur për çdo person, pavarësisht nga ngjyra, etnia, komuniteti, feja e të tjera, nuk ka dallime në këtë aspekt, por aty ka të bëjë me përgatitje profesionale dhe në këtë kuptim është testi me shkrim dhe me gojë. Nuk mund ta marrësh me mend që ndoshta për një vend të punës mund të konkurrojnë 200 kurse vetëm 1 pranohet, kjo sepse vie në shprehje konkurrenca dhe kur hapen konkurset duhet të konkurrojnë edhe personat e komuniteteve jo shumicë, kurse

arsyeja përse nuk konkurrojnë mund të jetë çështje tjetër që mund të merreni ju si komunitet jo shumicë, jo ne si Komunë, prandaj nuk bënë ta përdorësh atë shprehje “Etnikisht” sepse është çështje pastaj paksa më e rëndë.

Te çështja e strehimit, unë e di sa janë sepse çdo familje e kam vizituar, 6 familje janë në gjendje të rëndë të strehimit dhe pa kulm mbi kokë thuajse, 3 familje nuk kanë pronë e që pa pronë nuk mund të bëhet ndërtim, prandaj duhet të jemi të saktë kur flasim me shifra, 46 kërkesa janë për renovim të shtëpive, dhe në ato pjesë ku nuk ka pronë nuk mund të ndërtohet, madje ka edhe vende ku është kërkuar mbindërtim që t’ju zgjidhet çështja disa prej familjeve që janë me numër të madh të anëtarëve. Sigurish e dini që unë kam edhe fotografi, kam edhe dokumente por edhe dëshmi për çdo familje të komunitetit jo shumicë dhe madje jam në gjendje t’ju jap edhe raportin përkatës për gjendjen e tyre, mirëpo nuk është gjendja aq alarmante ashtu siç u paraqit sepse ne bashkërisht po jetojmë këtu dhe i dim, edhe nga komuniteti shumicë, besojeni ose, apo mund të shkoni deri në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe të shikoni sa kërkesa janë të komunitetit shumicë që nuk kanë “kulm mbi kokë”, këtë jua preferoj unë që të shkoni te zyrtarja znj. Arbresha Bashota dhe të shikoni. Përndryshe është pika e rendit të ditës kur të vie për strehim, banim dhe prona dhe mund të vijnë ata që janë kompetentë dhe t’jua sqarojnë për këto çështje. Prandaj të mos mi ekzagjerojmë temat dhe të dalim nga një temë në tjetrën sepse i vie radha çdo Drejtorie të vije këtu në mbledhje dhe t’ju informoj për çka do qoftë që ju intereson.

Edhe njëherë e them që të mos përdorim terme siç u ceken ngase ju them se nuk ka diskriminim, kurse në momentin që e cek “Etnikisht” aty me automatizëm nënkuptohet që ka diskriminim e që kurrë nuk ka pasë në Podujevës diskriminim në këtë aspekt të komuniteteve. Nëse je i zoti urdhëro, konkurro, pranohesh në punë dhe nuk ka të keqe asgjë, ndërsa jo me fjalë të, tilla sepse është fjalë jo e mirë paksa për neve si Komunë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ju falënderoj i nderuar Liman sepse ndoshta unë e gabova që e ceka atë fjalë por nuk ishte fjala për diskriminim, nuk nënkuptohet ajo mirëpo nuk gjeta term tjetër më të butë në atë çështje që nuk është asnjë person i komuniteteve jo shumicë i punësuar në Komunën e Podujevës.

z.Liman Zeqiri, Shef i ZKKK, theksoi, i nderuar zotëri Ademi, nuk kanë konkuruar nga komuniteti jo shumicë për punësim, askush nuk mund të vije dhe t’ju thotë eja konkurro se jeni ekonomist apo jurist ta zëm, mirëpo ka të, punësuar në Polici, ka në Ujësjellës, ka në Kompaninë “Pastrimi” dhe të tjera, pra edhe në Komunë konkursi është i hapur për çdo qytetar sepse është e qytetarëve pavarësisht racës, nacionalitetit, gjuhës, kombit, etnisë, fesë e të tjera. Prandaj nuk ka ashtu siç e ceke “Etnikisht” sepse nuk jemi më duke jetuar në atë regjimin e atyre që kanë shkuar, andaj nuk bënë të përdoren terem të tilla.

z.Rrahim Sejdiu, theksoi, një propozim e kam, ne e dim që prona nuk kemi si komunitet jo shumicë, mirëpo edhe nëse kemi kushte që të blejmë ndonjë tokë/pronë, kemi raste, dy-tri raste, që i dim që kanë blerë tokë/pronë dhe nuk lënë që në pronat e veta të ndërtojnë diçka, këtë rast e dinë shumë mirë edhe Komuna, është i lajmëruar në Polici, në Gjykatë, dhe nuk i lënë të punojnë dhe të ndërtojnë në pronat e veta, e kanë blerë dhe paguar atë por nuk lënë të ndërtojnë, pengohen të ndërtojnë. Pra këtë deshta t’jua tregoj që ka raste që edhe po që se kemi mundësi të blemë toka ne komuniteti jo shumicë, nuk na lënë të ndërtojmë.

Kryesuesi i Komitetit, pyeti parafolësin se ku janë ato raste dhe kush janë ata perona nëse mund të na tregosh.

z.Rrahim Sejdiu, vazhdoi, rasti konkret është në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.”Xhafer Meta” ku një person ka blerë pronë i cili është edhe punëtor i Komunës së Podujevës, konkretisht pastruesi që punën këtu në Komunë, i cili ka blerë pronë 5 ari, pastaj është Sabriu,

është Rashiti që ka blerë 10 ari tokë që janë blerë në qytet dhe që nuk i lënë të ndërtojnë, madje as mur, as themel as asgjë. Këto raste janë të lajmëruara edhe në Polici, edhe në Gjykatë dhe e dim shumë këtë çështje.

z.Besim Latifi, theksoi, pyetje për parafolësin, a janë persona privat që nuk i lënë të ndërtojnë apo bëhet fjalë për, institucione.

z.Rrahim Sejdiu, theksoi, po çështja ka të bëjë me perona privatë që nuk i lënë të punojnë ata persona të komunitetit jo shumicë të cilët kanë blerë prona dhe nuk mund të ndërtojnë si shkak i pengesa që i'u bëhen privatisht, qofshin fqinjë ose ndokush tjetër.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës përfunduan, kështu që e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, lus anëtarët e këtij Komiteti për Komunitete nga radhët e komunitetit jo shumicë Rom Ashkali dhe Egjiptas që të merren më shumë me problemet e komunitetit jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës, të jenë pak më të angazhuar në këtë aspekt dhe të marrin fjalën e jo ato t'i paraqet dhe të diskutoj vetëm një njeri sikurse që isha unë në këtë mbledhje.

Po ashtu të angazhohen tani në këtë fazë kur është regjistrimi i nxënësve në shkolla sepse koha po kalon qoftë për Klasën e I-rë dhe për parashkollor, qoftë për nivele tjera, në mënyrë që të mos mbesin nxënës pa u regjistruar në shkolla, pra lus dhe njëkohësisht kërkoj të angazhoheni nëpër lagjet ose fshatra ku jetoni në mënyrë që në këtë problematikë që herë pas here na është paraqitur neve si komunitet jo shumicë të mos kemi edhe tani probleme, kjo pasi që mund të ketë ndonjë prej prindërve që e neglizhon çështjen e regjistrimit të fëmijëve të vet, kështu që të ketë shtim të angazhimit në këtë aspekt dhe në mbledhjen e radhës ta dim se a ka fëmijë të komuniteti jo shumicë pa regjistruar në shkollim apo nuk ka.

Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën në këtë pikë të rendit të ditës Të Ndryshme, atëherë e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Konstatohet e përfunduar kjo mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0050036/26
Podujevë, 18 gusht 2026**

**Kryesuesi i zgjedhur e Komitetit
Xhafer Ademi**